

PKR.nr.170/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri, me zyrtarin ligjorë Arianit Mahmutaj, në lëndën penale ndaj të akuzuarit P.K. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.1322/2014 të dt: 12.03.2015, pas mbajtës së shqyrtimit fillestar publik me dt:17.05.2018, në prezencën e të akuzuarit P.K., mbrojtës të tij av.M.A. dhe prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri, të njëjtën ditë bjenë e në prezencë të palëve publikisht shpall:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

P.K. nga i ati A. dhe e ema H., e vajzerise K., i lindur me ... në f.sh.”Ll.” K-P., ku edhe jeton, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme teknike - ndërtimtari, jo i punësuar, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal ...

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Nga data e pa përcaktuar e deri me dt: 19.11.2014, rreth orës 08:45, në shtëpinë e tij, pa autorizim ka poseduar armën, në atë mënyrë që fillimisht ka postuar në rrjetin social “Facebook” një foto të tij me armë në dorë dhe pas kërkesës së policisë, u dorëzon armën e tipit Colt Aduble Eagle me nr.serik D9351283 e cal.9mm,-

-me çka ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të aautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve: 2,4,17,21,41,42,43,49,50,51,52,62,73,74,75,76 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 450 të KPPK-së .

Të akuzuarit **P.K.** për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i shqiptoi **DËNIM ME**

BURGIM- DËNIM TË KUSHTEZUAR –në kohëzgjatje prej **gjashtë (6) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i gjykuari nuk kryen veprën tjetër penale, në periudhë kohore prej **një (1) viti**.

MBI DËNIMIN PLOTËSUES

Konform nenit 62 par.2 nën.par.2.6 të KPRK-së ndaj të akuzuarit P.K. konfiskohet armëa e tipit Colt Aduble Eagle me nr.serik D9351283 e cal.9mm dhe një karikator, e cila është sekuestruar nga policia, si mjete me të cilat është kryer vepra penale dhe e njejta duhet të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

MBI SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE DHE PAUSHALLIN GJYQËSOR

I akuzuari **P.K.**, obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej **50 € (pesëdhjet) Euro**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.1322/2014 të dt: 12.03.2015, ndaj të akuzuarit P.K. për shkak të veprës penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll ose Posedim të Paautorizuar të Armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me dt: 17.05.2018, i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sqarim shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranojë, ose mos te pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vihet në barrë, i akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPK-së, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabime faktike.

Duke marr parasysh se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestar konform nenit 248 par.4 të KPPK-së kur kryetari i trupit gjykues mund të vazhdon procedurën me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësor dhe pa e plotësuar trupin gjykues, gjykata pa fjalë përfundimtare, pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, të njëjtën ditë vazhdoi me shqiptimin e dënimit, duke marr parasysh se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të dënimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, jo i punësuar, gjendjes së dobët ekonomike më parë jo i gjykuar. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i aplikuar dispozitat ligjore për zbutjen e dënimit, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe më të njëjtën do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit, siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi dënimin plotësues është marrur konform nenit 62 par.2 nën.par.2.6 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, është marr konform dispozitave të nenit 453 par 4, të KPPK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.170/15, të dt: 17.05.2018

Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Palët në procedurë hjekin dorë nga e drejta në ankesë.